



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 437/5 prot.

Tiranë, më 3.11.2023

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 702, të datës 27.9.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Agron Bushati
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F i aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 19.10.2023, është njoftuar vendimi nr. 702, i datës 27.9.2023, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Agron Bushati, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Shkodër.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, si përfaqësues i interesit publik, neni F të aneksit të Kushtetutës dhe neni 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin përfundimtar të marrë nga Komisioni për subjektet e rivlerësimit, brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 702, të datës 27.9.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

### I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Agron Bushati, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Shkodër. Referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 4, të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni) ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në

vijim referuar si ILDKPKI), Raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe Raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim referuar si KLP), nga të cilat rezultojnë se:

**2.1 ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Agron Bushati<sup>1</sup>”, ka referuar për subjektin se:

- i. *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii. *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e tij;*
- iii. *nuk ka kryer fshehje të pasurisë ndër vite;*
- iv. *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- v. *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**2.2 DSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të Raportit<sup>2</sup> mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, i ka referuar Komisionit: “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës”.

**2.3 KLP**, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit Raportin<sup>3</sup> për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit, z. Agron Bushati.

**3.** Përfundimet e Komisionit, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

**3.1 Për vlerësimin e pasurisë.** [...] *Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ai ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Agron Bushati, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatoheshin parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Agron Bushati, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...].*

**3.2 Për kontrollin e figurës.** [...] *Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Agron Bushati, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të shkronjës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...].*

**3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale.** [...] *Në përfundim të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale. Komisioni vlerëson se problematikat e konstatuara nga denoncimi i datës \*\*.9.2023 nuk ngrihen në nivelin e shkakut, që e bëjnë subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm, në kuptim të nenit 44, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, për të justifikuar vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas parashikimeve të nenit 61, pikat 4 dhe 5 të këtij ligji. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...].*

<sup>1</sup> Raporti me nr. \*\*/\*\* prot., datë \*\*.4.2018, i ILDKPKI-së.

<sup>2</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2017, i DSIK-së (deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. \*\*\*, datë \*\*.10.2022).

<sup>3</sup> Raport i KLP-së, nr. \*\*\* prot., datë \*\*.6.2023.

**4. Vendimi i Komisionit.** Nisur nga përfundimet e mësipërme, për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në bazë të nenit 58, pika 1, shkronja “a”, nenit 59, pika 1, dhe të nenit 60 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka vendosur (ndër të tjera, si pjesë e dispozitivit):

- i. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Agron Bushati, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Shkodër.*
- ii. Në zbatim të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, të referojë pranë organit kompetent (ILD) për vlerësim denoncimin e ardhur pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në datën \*\*9.2023, bazuar në nenin 103/e, të ligjit nr. 96/2016.*

## **II. Vlerësimi i Komisionerit Publik**

**5.** Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting). Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

**6.** Në krahasim me kompetencat e njohura Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, në momentin procedural të njoftimit të vendimit të Komisionit, sipas nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

**7.** Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet përfundimtare të dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij, në të cilën janë arsyetuar në mënyrë të plotë konkluzionet dhe qëndrimi i Komisionit për procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

**8.** Sa më sipër, Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 702, datë 27.9.2023, çmon se ai përmban shkaqe ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Komisioneri Publik, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ushtron të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 702/2023, të Komisionit, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, në tërësinë e tij.

### **II.A Vlerësimi lidhur me aspekte të zbatimit të ligjit**

**9.** Në vlerësimin e Komisionerit Publik, në çështjen objekt shqyrtimi, shtrohen paraprakisht aspekte të zbatimit të ligjit, sa vijon:

**9.1** Jurisprudenca e Kolegjit, lidhur me zbatimin e pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, për kompetencën e Komisionit të transferojë çështjen pranë organit kompetent për inspektim, ka vendosur standardin që duhet të plotësohen dy kushte në mënyrë kumulative për të gjetur vend zbatimi i kësaj kompetence dhe, më konkretisht, praktikat të cilat transferohen për inspektim në organet kompetente, në parim: (1) duhet të përmbajnë shkelje joserioze, pa pasoja të rënda procedurale për palët, dhe (2) shkelja duhet të jetë brenda afateve të parashikuara në nenin 117 të ligjit nr. 96/2016. Referuar nenit 117, të ligjit nr. 96/2016, pika 1, përcaktohet se shkeljet disiplinore parashkruhen brenda pesë vjetëve dhe, nëse një ankesë

paraqitet pas pesë vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk verifikon ankesën për shkak të parashkrimit. Kolegji, me vendimin Juridiksion Rivlerësimi, me nr.2/2020, këtij rregullimi procedural i ka dhënë fuqi nëpërmjet orientimit të Komisionit për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme.

**9.2** Jurisprudenca e Kolegjit lidhur me shkakun ligjor të “cenimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë” ka vendosur standardin se është plotësisht e përshtatshme që institucionet e rivlerësimit të japin masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, pasi vetë ligji nr. 84/2016, në nenin 61, pika 5 e tij, autorizon në mënyrë specifike një masë të tillë disiplinore, në rastet kur subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, duke vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe objektive tërësinë e sjelljeve të subjektit të rivlerësimit dhe mbrojtjen e interesit publik në këtë proces. Për sa i përket matjes së cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, jurisprudenca e Kolegjit ka vendosur standardin që institucionet e sistemit të drejtësisë duhet të gjenerojnë besim të vazhdueshëm te publiku, duke vepruar në mënyrë efektive dhe të drejtë, në përputhje me legjislacionin dhe duke e demonstruar këtë te qytetarët. Ka një sërë sjelljesh nëpërmjet të cilave subjektet e rivlerësimit minojnë integritetin e institucioneve të drejtësisë dhe cenojnë besimin e publikut në sistemin tonë të drejtësisë, përmes korrupsionit, marrëdhënieve të rreme, shkeljes së betimit si nëpunës publik, veprimit në situatën e konfliktit të interesit, paaftësisë në punën profesionale, vendosjes së interesave private përpara interesit publik etj.

### **III. Analiza e shkaqeve të ankimit**

#### **III.A Gjetje në vlerësimin e aftësive profesionale**

**10** Komisioni, për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, ka administruar dhe shqyrtuar: (i) Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (ii) të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme; dhe (iii) denoncimet nga publiku.

**11** Në aktin “Relacion mbi rezultatet e hetimit”, datë 19.9.2023, Komisioni, referuar praktikës dokumentare të përcjellë nga Prokuroria e Përgjithshme, i ka kërkuar sqarime subjektit të rivlerësimit lidhur me tri procedime penale: (1) procedimi penal me nr.\*\*\*, i vitit 2000, për veprën penale “Vjedhje”, të parashikuar nga neni 134, paragrafi 1, i Kodit Penal; (2) procedimi penal me nr. \*\*\*, viti 2003, regjistruar për veprën penale “Vrasje me paramendim”, parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal, kryer në bashkëpunim dhe veprën penale “Prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuar nga neni 278, paragrafi 2 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve \*\*\* dhe \*\*\* \*\*\*, (3) procedimi penal me nr. \*\*\*, viti 2005, për veprat penale “Plagosje e rëndë me dashje” dhe “Prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuara nga nenet 88, paragrafi 1 dhe 278, paragrafi 2 i Kodit Penal. Komisioni ka konstatuar se subjekti ka zvarritur procedimet penale për periudha të gjata kohore, duke i kërkuar shpjegime.

**12** Lidhur me konstatimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka dhënë përgjigje në aktin “Shpjegime për rezultatet e hetimit administrativ”, datë 24.9.2023, të cilat janë marrë në vlerësim nga Komisioni.

**13** Komisioni, ka arritur në përfundimin se: [...] *pas analizimit të shpjegimeve të subjektit, pavarësisht se duken bindëse, ato janë në nivel deklarativ dhe të pashoqëruar me prova për të mbështetur pretendimet e tij. Për rrjedhojë, nga ana e subjektit rezulton se janë shfaqur mangësi në kriterin e aftësive organizative. Në lidhje me këto mangësi rezulton se ndaj subjektit është marrë një masë disiplinore dhe, pas përfundimit të kësaj mase, ai nuk ka vijuar më tej me kryerjen e të njëjtave veprimeve si në rastin e procedimeve të mësipërme. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se ato janë korrigjuar nga subjekti përgjatë 14 viteve pune në vijim të tij, pasi nga 5 dosjet e përzgjedhura me short dhe nga 3 vendimet e depozituara prej*

*tij nuk janë konstatuar zvarritje të procedimeve penale [...], si dhe [...] duke marrë në konsideratë faktin se subjekti ka marrë një dënim në lidhje me këto procedime, si dhe nuk ka vijuar më tej me zvarritjen e procedimeve, vlerëson se nuk jemi përpara plotësimit të kriterëve për ta ngarkuar subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore, si dhe për t'u konsideruar si shkak për marrjen e masës së shkarkimit nga detyra [...].*

**14** Komisioneri Publik, marrë në konsideratë se procedimi penal me nr. \*\*\*, viti 2003, është regjistruar për veprën penale “Vrasje me paramendim”, kryer në bashkëpunim dhe veprën penale “Prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, ku marzhi minimal i dënimit fillon me burgim pesëmbëdhjetë vjet dhe se ushtrimi i ndjekjes penale nuk parashkruhet pa kaluar njëzet vjet, vlerëson se shkelja e konstatuar në mosveprimin e subjektit të rivlerësimit, është e tillë që kualifikohet në ato që cenojnë besimin e publikut të drejtësia, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

#### **15 Denoncim<sup>4</sup> i shtetasit \*\*\* \*\***

**15.1** Qytetari \*\*\*. \*\*\*, ka paraqitur denoncim pranë Komisionit, me anë të të cilit ankohet për subjektin e rivlerësimit se ka humbur fashikullin e procedimit penal të vitit 2002, për ngjarjen me të dëmtuar z. \*\*\*. \*\*\*, kanosur seriozisht për jetën nga shtetasi \*\*\*. \*\*.

**15.2** Komisioni, gjatë hetimit administrativ ka administruar<sup>5</sup> nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë, kopje të fashikujve të kallëzimeve penale të paraqitura nga denoncuesi \*\*\*. \*\*\*, në vitet 2008, 2009, 2010, me objekt kryerjen nga subjekti i rivlerësimit të veprës penale “Shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, dhe veprën penale “Zhdukja ose humbja e fashikullit”, parashikuar nga neni 313/a i Kodit Penal.

**15.3** Komisioni, në aktin “*Relacion mbi rezultatet e hetimit*”, datë 19.9.2023, në rubrikën denoncime, për këtë denoncim ka arritur në konkluzionin se bazuar në dosjen e ankesës nuk paraqiten shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njëanshme apo korruptive nga ana e subjektit të rivlerësimit.

**15.4** Komisioni ka arritur në përfundimin se: [...] *bazuar në dosjen e ankesës nuk paraqiten shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njëanshme apo korruptive nga ana e subjektit të rivlerësimit [...].*

**15.5** Komisioneri Publik, lidhur me këtë përfundim të Komisionit, ka qëndrim ndryshe për sa vijon:

**15.5.1** Referuar vendimit të Gjykatës së Lartë me nr. \*\*\*, datë \*\*.4.2014, administruar në dosje të Komisionit, vërejmë se Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.10.2012, ka konstatuar situatën faktike, si vijon:

- [...] *Agron Bushati, me funksion publik të prokurorit, nuk ka kryer veprime që ligji, e pikërisht neni 287 i Kodit të Procedurës Penale, e detyron t'i kryejë, siç është ai i shënimit në regjistër i njoftimit të veprës penale të marrë nëpërmjet kallëzimit të mbërritur me shkresën nr.\*\*\* prot., datë \*\*.9.2002, të Komisariatit të Policisë Shkodër. Çka qartazi përbën mospërbushje të rregullt të detyrës së tij për “...zhvillimin, brenda kompetencave të caktuara të hetimeve të nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale” (pika 1, neni 277 i K. Pr. P.), njëri nga të cilët është edhe “regjistrimi i njoftimit të veprës penale”, të cilën ai nuk e ka kryer [...].*

- [...] *Po ashtu, e hapur është edhe pasoja e “dëmtimit të interesave të ligjshme të shtetit” të disiplinimit të kryerjes së hetimeve të nevojshme për ushtrimin e ndjekjes penale, si dhe i interesave të ligjshme të qytetarit \*\*\* \*\*\*, si i dëmtuar nga vepra penale e kanosjes, për*

<sup>4</sup> Protokolluar ne Komision me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2018.

<sup>5</sup> Përcjellë me shkresën nr. \*\*\*/\*\* prot., datë \*\*.4.2023.

*procedimin e fajtorit (pika 1, neni 58 i K. Pr. P.), të cilën ai, mbi bazën e pikës 1, të nenit 283, të K. Pr. Penale, ka kallëzuar si veprë penale që ndiqet kryesisht nga Prokuroria dhe Policia Gjyqësore [...].*

**15.5.2** Referuar procesverbalit për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, të datës \*\*\*12.2008, subjekti i rivlerësimit, z. Bushati, pyetjes së prokurorit \*\*\* \*\*\*, se çfarë kujton nga kallëzimi i shtetasit \*\*\* \*\*\* ndaj shtetasit \*\*\* \*\*\*, i është përgjigjur se nuk është në gjendje të kujtojë asgjë në lidhje me kallëzimin e bërë nga shtetasi \*\*\* \*\*\*, pasi bëhet fjalë për një hark kohor të konsiderueshëm.

**15.6** Në përfundim, Komisioneri Publik vlerëson se shkelja e konstatuar në mosveprimin e subjektit të rivlerësimit është e tillë që kualifikohet në ato që cenojnë besimin e publikut të drejtësia, në kuptim të nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016.

## **16 Denoncim,<sup>6</sup> me postë elektronike, i datës \*\*.9.2023**

**16.1** Komisioni, një ditë para zhvillimit të seancës dëgjimore, administroi denoncimin e shtetasës \*\*\*. \*\*\*, e cila pretendon se subjekti, nën kërcënimin e armëve të ftohta, ka kërcënuar e kanosur qytetarin në mes të qytetit, ky *email* është shoqëruar me një video.

**16.2** Komisioni, pasi u njoh dhe vlerësoi denoncimin, ka vendosur vënien në dispozicion të subjektit të rivlerësimit denoncimin dhe dhënien e kohës së nevojshme për të dhënë shpjegime.

**16.3** Subjekti i rivlerësimit, në seancë dëgjimore, është përgjigjur se ngjarja ka ndodhur në vitin 2017-2018, në makinën e tij, me bashkëshorten, e cila ka regjistruar videon, dhe vajzën e tij, zëri i së cilës dëgjohej duke qeshur, dhe se ka qenë një ngjarje intime brenda familjes, një shaka që po bënte për të ngritur humorin e vajzës, e cila kishte pasur një ditë/ngjarje jo të këndshme dhe ai kishte dashur ta bënte për të qeshur, duke u hequr si një personazh i filmave vizatimorë, dhe se kjo ngjarje nuk ka pasur lidhje me asnjë qytetar dhe nuk ka pasur elemente kanosjeje ndaj askujt, se këto armë të ftohta i ka marrë për pak minuta nga dhoma e provave të Prokurorisë, ku punonte, duke pretenduar se të tilla mjete mund të bliheshin në atë kohë në treg, lirisht.

**16.4** Komisioni ka analizuar çështjen, duke pasur parasysh dy elemente: [...] *mbajtjen e armëve të ftohta dhe nxjerrjen e tyre nga dhoma e provave të Prokurorisë, duke qenë se ngjarja ka ndodhur në vitin 2017, pra pas periudhës objekt rivlerësimi, zhvillohet në një mjedis të mbyllur, privat, siç është makina e subjektit, vendosi të dërgojë këtë denoncim pranë ILD-së, me qëllim hetimin e mëtejshëm në funksion të mundësisë për shkeljen e etikës nga Prokurori [...].*

**16.5** Komisioneri Publik, në analizë të situatës faktike të përshkruar më sipër, në raport me legjislacionin e zbatueshëm, vëren se veprimi i kryer nga subjekti i rivlerësimit vjen në kundërshtim me standardet e etikës dhe rregullave të sjelljes së magjistratit, parashikuar nga neni 4, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, i cili përcakton se: *Magjistrati merr të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur dinjitetin e funksionit, duke përfshirë veprimtaritë e kryera, edhe kur magjistrati nuk është duke ushtruar funksionet zyrtare.*

**16.6** Referuar jurisprudencës së Kolegjit, parashtruar në pikën 9.1 të këtij ankimi, ngjarja ka ndodhur në vitin 2017, siç konfirmon Komisioni, dhe kanë kaluar pesë vite, duke e bërë të paverifikueshme nga ILD-ja, në zbatim të nenit 117, pika 1 e ligjit nr. 96/2016. Pra, kjo shkelje efektivisht nuk është objekt kontrolli nga organet e tjera, arsye për të cilën i paraqitet juridiksionit kontrollues të Kolegjit.

---

<sup>6</sup> Denoncim i përcjellë Komisionit dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, në rrugë elektronike, me *email*-in e datës \*\*.9.2023, në orën 18:13.

**16.7** Në përmbledhje të sa më sipër, Komisioneri Publik vëren se sjellja e subjektit të rivlerësimit bie ndesh me mënyrën e sjelljes që pritet nga një prokuror, i cili duhet të kujdeset që veprimet e tij të jenë në përputhje me detyrimet e marra përsipër, duke e vendosur subjektin në situatën e kualifikuar nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si cenim i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

#### **IV. Kërkimi i ankimit**

**17.** Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale;

**18.** Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

**19.** Në të tilla kushte, ku subjekti rezulton me mangësi dhe mospërmbushje të kërkesave të parashikuara në aneksin e Kushtetutës dhe legjislacionin e posaçëm, për kriteret e procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik çmon se, nga vlerësimi tërësor i çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për subjektin konkret duhet të gjejë zbatim neni 61, pikat 4 dhe 5, të këtij ligji;

**20.** Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, DH dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenit 4 dhe nenit 61, pikat 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016;

**21.** Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 702, datë 27.9.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Agron Bushati.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Irena NINO**